

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim [REDAKTUAR], kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizaj, në çështjen për rimbursim dëmi, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur, më datë 05.10.2016, në praninë e përfaqësueses së paditëses dhe në mungesën e të paditurit, mori:

## A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET** në tërësi kërkesë padia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve Prishtinë, si e bazuar,

**II. DETYROHET** i padituri [REDAKTUAR] nga fsh [REDAKTUAR] Komuna e Ferizaj, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit t'i paguajë shumën prej 2,249,00 € të gjitha me kamatën ligjore nga dita e ngritjes së kësaj padie e deri në ditën e pagesës përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 € të gjitha në afat prej 15 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m i

Përfaqësuesja e paditëses në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbet në tersi pranë padisë dhe kërkesës së saj, nga raporti policor, raporti i hetuesit si dhe shkresat tjera tregojnë qartë se tani i padituri [REDAKTUAR] ka qenë shkaktar i këtij aksidenti, gjithashtu me ligjin mbi LSDA neni 14 par.4 neni 19 e neni 20 par.5 është paraparë që shumat të cilat BKS-ja ia kompenson të dëmtuarve, të njëjtën shumë ta rimbursoj nga shkaktari i aksidentit në automjet të pasiguruar me regjistrim të huaj, të pidentifikuar dhe me sigurim të fituar respektivisht nga i padituri në rastin konkret.

I ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesë padia e paditëses si e bazuar si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I padituri [REDAKTUAR] është ftuar me rregull për seancën e dt.05.10.2016 por i njëjti nuk është paraqitur ne seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë nxjerrjen e provave: me leximin e padisë së paditësit dt.28.04.2015, raporti policor, urdhërtransferi, vendimi i komisionit për kompensim i paditëses, aktvlerësimi.

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimin të tyre, në kuptim të nenit 18 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia është e bazuar.

Gjykata me rastin e vlerësimin të bazueshmërisë së kërkesëpadisë, konsideron se e njëjta bazohet në provat e administruara dhe atë automjeti me të cilin është shkaktuar dëmi VW Golf me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] nuk ka qenë i siguruar respektivisht i kishte afati i periudhës së sigurimit.

Me leximin e raportit të policitë hetues 2012-CFT-482 dt.29.08.2012, gjykata ka vërtetuar se është shkaktuar aksidenti i komunikacionit në Ferizaj në rr" Dëshmorët e Kombit" me dt.29.08.2012 në të cilin aksident kanë marr pjesë dy automjete edhe atë automjeti i markës Volfvagen Golf me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] të cilin e drejtonte i padituri [REDAKTUAR], dhe automjeti i udhëtarëve Opel Vectra me targë të regjistrimit [REDAKTUAR], të cilën e drejtonte [REDAKTUAR].

Me vendimin e komisionit për vlerësimin e dëmit FK.1404/2012 i datës 27.09.12 paditësja ka vendosur që të dëmtuarve në këtë aksident trafiku tiu paguhet shpërblimi i dëmit në shumë prej 2,249.00 euro, shumë e cila është caktuar nga ujdia jashtëgjyqësore meqenëse gjykata ka vërtetuar se nga aksidenti i komunikacionit është shkaktuar dëm material dhe jo material tek të dëmtuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].

Nga ujdia jashtë gjyqësore shihet se Komisionit ka vlerësuar se të dëmtuarve në emër të dëmit material dhe jo material ti paguhet shuma prej 2,249.00.

Gjykata bazuar në vlerësimin e provave lidhur me faktet, ka vërtetuar se deri te aksidenti ka ardhur kur i padituri [REDAKTUAR] me automjetin e tij ishte duke qarkulluar nga drejtimi i pompës se benzinit në drejtim të qytetit dhe me të arritur përball ish Vegël tores vetura Vofsvagen të cilën e drejtonte i padituri [REDAKTUAR] fillon të ç kyçet nga rruga në anën e majtë për të hyre ne dyert e Vegëltores këtë veprim e merr pa u bindur mirë se me këtë veprim mund ti rrezikoj pjesëmarrësit e tjerë ne komunikacion dhe ne atë moment nga drejtimi i kundërt i lëvizjes vjen vetura Opel Vectra te cilën e drejtonte i dëmtuari dhe me pjesën e parë përparme të anës së majtë i pandehuri e godet automjetin e të dëmtuarit ku përpos dëmeve materiale ne të dy automjetet lëndime trupore pësojnë të vozitësi dhe pasagjerët e tij.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit material ka vendosur sipas vlerësimin të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së dhe në dispozitat e nenit 178 par.1 të LMD-së si dhe Ligjit për Sigurimet e Detyrueshme nga autopërgjegjësia, sepse rasti i siguruar nuk ka qenë i siguruar dhe nuk është mbuluar me polis të sigurimit, për çka detyrohet e paditura të bëjë regresimin e dëmit në shumë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të shpërblimit të dëmit material, paditësit ja ka njohur të drejtën në kamatë ligjore prej ditës së ushtrimit të padisë dt. 28.04.2015, deri në


pagesën definitive si për mjetet e deponuara në banka mbi një vit, pa destinim të caktuar, në kuptim të nenit 277 al.1 të LMD-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 449.2 të LPK-së, andaj i padituri obligohet të paguaj për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 15€ dhe aktgjykim prej 15€, e që shuma e përgjithshme prej 30 euro, e cila është llogaritur në bazë të shumës së aprovuar të kërkesëpadisë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ  
C.nr.252/15, dt. 00.12.2014.

B.Profesionale  
Mirlinda Bytyq Rexhepi



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II-FUROSEVAC

Më  
Dana

